




**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL V/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së V (pestë) për vitin 2026 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 20.05.2026
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi
z. Enver Shabani
znj. Mimoza Bajraktari
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Laureta Tafaj
z. Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Rishqyrtimi i projekt-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve 'Emblema e artë', 'Skenderbeu', dhe mirënjohjen '13 Qershor';**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit të ankesave për bursa për nxënës dhe student;**

6.Njoftim për shkëputjen e kontratës;

Kryesuesi-i njofton për dy pika shtesë

- 1.Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal;**
- 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-17647;**

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin për pikën e par shtesë

Flamur Bytyçi-përshendetje për të gjithë,një sqarim a ka me qenë e njëjta form e pagesave për Kryetarët e këshillit lokal?

Kryesuesi-po,dhe hedh në votim pikën e par shtesë

Unanimisht miratohet

Kryesuesi-e elaboron pikën e dyt shtesë

Laureta Tafaj-përshendetje për të gjithë,kur e kemi fillu këtë punë ne nuk ishim shumë të sigurt por e kemi ditë që kemi me hap një derë që kan me na ardh shumë raste të tilla që nuk kan faj as qytetarët sepse është fatkeqësi,ne nuk mundemi as me i refuzu por nuk po mundemi as me gjetë një rrug tjetër prej një fondi që me qenë të emergjencat se na e kan hek dhe mendoj që duhet me kalu dhe me shku në Asamble.

Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,është vendim i ndjeshëm por po më shqetëson fakti që ky e ka bë kerkesen me 27.07.2025 dhe mbas 7 muaj neve na ka ardh këtu dhe nuk është serioze sepse në parim nuk jam kundër për me i ndihmu.

Enver Shabani-përshendetje për të gjithë,deshta me u ndërlidh me Laureten është një procedur tjetër që mundemi me kalu me formu një komision nga Komuna ose nga Asamblea dhe komisioni që formohet e bën vlerësimin e dëmit dhe ai raport ndaj vlerësimit të dëmit vjen në Asamble aprovohet dhe shkon në Agjencionin e menaxhimit të emergjencave ku kan një fond të veqant për ndarjen e këtyre dëmeve që ndodhin

Laureta Tafaj-faleminderit për sqarimin,atëher ne jemi të mjaftueshëm këtu për me arrit me bë një vendim të till që me dergu në Asamble me formu një komision që në të ardhmen mos me has në kësi lloj probleme vazhdimisht me 5000€ as nuk i mjaftojn atij e as nuk jemi tu dit se qysh jemi tu i ndihmu qytetarët.

Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,kjo praktik kur po vjen dhe ne po jemi pak më të ndjeshëm ndaj këtyre situatave e sidomos kur është fjala për fermerë,ndoshta duhet pak me fillu me i ndryshu praktikat është mir me bë një projekt-vendim të përgjithshëm dhe atë projekt-vendim me ja lën si kompetenc një komisioni që i bën verifikimin e dëmeve,ne për momentin për këtë rast konkret nuk kemi as verifikim të dëmeve ndoshta ai e ka renovu atë pjesë që ju ka dëmtu por tash po e kërkon kompenzimin nuk e di situaten se nuk e kemi pa dhe nuk i kemi raportet përpara por propozimi është që me bë një projekt-vendim të përgjithshëm mos me shqyrto ne si Kuvend secilin rast por me len ne kompetenc të një komisioni me bë verifikimin e dëmeve çështja mandej me kalu te Agjencioni ndoshta ish kan edhe më idealja për derisa edhe me ligj po i takojka ata ndoshta edhe jan më pak se na të ndjeshëm ndaj këtyre situatave dhe vlerësojn me drejtë ndoshta paguajn edhe më shumë në raste që ka dëmtim më të madh.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën shtesë

Unanimisht miratohet

Kryesuesi-e hedhë në votim rendin e ditës me dy pika shtesë

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2.Rishqyrtimi i projekt-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj- meqenëse veq është mbajtë ndëgjimi publik jam shumë kureshtare me ditë a është bë ndonjë raport nga ai ndëgjim,qka është nxerrë konkludim sepse aty ka pas dhe propozime që kan dal për rregulloren dhe a jan marrë parasysh apo nuk jan marrë parasysh ato rekomandime që kan dal nga ndëgjimi publik si dhe ndëgjimet publike nuk është që mbahen vetëm për formalitet dhe duhet të kryhet obligimi ligjor por duhet me i pranu propozimet e qytetarëve kështu që a është bë ai raport dhe qka është vendos rreth propozimeve që ka dal nga ai ndëgjim.

Avni Bytyçi-çështja e raportit është përsonei përgjegjës që merret me çështjen e konsultimeve publike dhe po besojë që raportin e ka përgadit,sa i përket çështjes së projekt-rregullores nuk ka

pas ndonjë koment apo rekomandim strikt dhe Kryetari ka kërku rekomandime nga të pranishmit aty mirpo nuk pas.

Sanie Kuçi Rexhepaj-ka pas rekomandime Urimi i ka thën rekomandimet e veta që veq me lexu i keni në procesverbal nëse nuk ju kujtohen dhe me rregull duhet raport mbi debatin publik dhe mandej a vendoset me u përfshi ato apo nuk vendoset është tjetër çështje por raporti i definon ato mirpo këto debate publike po me duket po i mbani vetëm sa për formalitet por qka u propozu në debat nuk ka fare rëndësi.

Avni Bytyçi-sa i përket rekomandimeve të Urimin unë kam dhën sqarim aty për aty dhe ne jemi në bisedime me Kryetarin siq kam qenë edhe më herët çështja e faljes apo liritimit nga kjo taks tek çështja e rasteve sociale nëse mundemi me arrit një mirëkuptim me Eko-regjionin që nese ata pranojn ndonjë familje me liru nga taksa që është rast social ekstrem.

Enver Shabani-a është diskutu lidhje me deponu për mbetje shtazore sepse ne jetojm në një ambient ku kemi shumë edhe fermerë a keni caktu ndonjë vend të veqant ku mund të groposen me procedura.

Avni Bytyçi-duhet të diskutohet në një formë të veqant.

Dardan Berisha-diskutimi publik është mbajtë por aty më ka pengu fakti edhe Kryetari por nuk e di kush e ka cek mundem me qenë edhe gabim është mundu me ja hedhë fajin Asambleistav që e kemi kalu me 6€ dhe unë kam reagu dhe kam thën që ky është moskordinim sepse edhe ne diskutimin që e kemi mbajtë me shefat e grupit parlamentar edhe Kryeshefi Burimi ka kërku që me kan 7.50€ dmth ne në përgjithësi nuk kemi pas harmoni të plot dhe kordinim të përbashkët pra Ekzekutivi dhe Legjislativi është mundu me kalu shpejtë e shpejtë ,sepse krejt diskutimi nuk është rregullorja por është tarifa për amvisëri,sepse nëse e shofim rregulloren ne bizneseve ja kemi rrit 35€ është kogja shumë dhe po ankohen bizneset,kur e kam diskutu ligjin për mbeturina që është i gatshëm prej organizatës Giz a i është projekt vetëm në Kuvendin e Kosovës por Kuvend spo ka qysh në mbledhjen e par duhet me kalu ligji për mbeturinave,sa i përket qytetarëve ata nuk jan tu e kontestu qmimin për amvisëri por esenca është që rregullorja si rregullore ka lëshime dhe kjo rregullore ka mundësi që ka me na ardh prap me ndryshu sepse është duke u bë ligji për mbeturina dhe është në përfundim.

Avni Bytyçi-rregullorja në aspektin përmbajtësor është në rregull ka pas 3 gabime teknike dhe për atë e kan kthy dhe ne e kemi korrigju,kërkesa kur na ka ardhë në fillim ka qenë 7.5 nga Eko-Regjioni te Kryetari unë si Kryesues i grupit punues bashkë me Grupin punues që ka qen edhe Kryeshefi ekzekutiv i njësis Suharekë kemi ardh në përfundim dhe ne e dijm që i kemi dëmtu bizneset dhe mërgaten duke tentuar që ekonomit familjare ti favorizojmë edhe e kemi bind Kryetarin dhe Eko-regjionin që ti rrisim tarifat e bizneseve dhe mërgatës dhe ekonomit familjare ti lë me 6€ me qëllim që të kaloj kjo rregullore dhe ata kan pranu por nëse analizojmë shumë thjeshtë Eko-Regjioni ka së paku 40.000€ të hyra mujore me këtë rritje që e ka aktualisht,në një far forme na keqpërdor tash po kërkon me rrit 7.5 ndërsa spo lejon me i ulë tarifat e bizneseve dhe mërgimtarëve.

Dardan Berisha-qekjo është esenca që ne nuk duhet me ra në ndikim as të Burimit as të askujt,dhe e para ai nuk ka të drejtë me i ndalu as pagesat me ligj por ai vetëm propagand e ka pas sepse nuk i ka ndalu pagesat më shumë se dy ditë,dhe ne si Asambleist po bijm pre e individave të caktum dhe kërkoj nga ju si Kryesues mos me i leju do sene me kan më shumë me neve se edhe ne po dalim keq sepse dy her brenda muajit me ndryshu tarifen.

Kryesuesi-çasja e Kryeshefit ka qenë shumë e gabume në një far forme është mundu të gjithë fajin me hudhë te Asamblea sepse ata nuk po e kalojnë faktikisht ne nuk jemi ata.

Flamur Bytyçi-realisht kam qenë pak më i zëshëm në aspektin e kësaj rregullore tu e dit që gjithmonë po tentohet nga një her me kalu do sene si shpejt e shpejtë pa u diskutu mirë,pika e par secili prej Asambleisteve kemi qenë të shantazhum e të kërcenum në një mënyrë të linçum publik pikërisht prej kësaj situatë tu e përfshi edhe ty Kryesues,gabimet e këtij problemi nuk jan tash që kan ndodh por jan të kalumes,ka pas një përfaqësues i joni i cili është edhe anëtar i bordit që ne jemi aksionar 13% dhe ne asnjëher nuk e kemi pas një raport se qka është ka ndodh me ndërmarrjen.Në mbledhjen që na ka thirrë Kryetari në takim e kam pas një pa kënaqësi për Zyrën e Kryetarit dmth na thirr Kryetari në takim dhe nuk vjen kërkush me mbajtë procesverbalin dhe duhna unë si Asambleist me lëshu me bo video rekord dhe kjo është njëra prej çështjeve që unë hala e kam në telefon dhe kërkush prej Ekzekutivit nuk më ka thirrë me më than amundesh mema dergu inqizimin për me bë një procesverbal takimit.Çasja e Kryeshefit për mu është shumë e pa pranueshme ti nuk mundesh me ardhë neve me na kërcënu dhe me na than që unëtash po i lëshoj parret nëse ti mu më garanton që më kalon,unë po quditëm me Kryetarin pse po ja lejon me ardh në takim neve me na u sill sikur para lufte,neve ai takim në zyrën e Kryetarit na ka degjeneru komplet që kemi qenë si përfaqësues unë tu kisha lut ty Kryesues në takim kur thirren shefat e grupev ose Asambleistave me qenë prezentë edhe ti me lu rolin tënd me i mbrojtë Asambleistave mos me u lan me u fy në këtë formë.Te tarifat kur ka ardhë për me ndryshu unë kam kërk me pas një raport të specifikun këte analizë për me votu rritjen tarifave.Që 4 vite përfaqësuesi jonë nuk ka raportu.Pyetje ime për këtë rregullore është qysh keni me i regjistru konsumatorët e kësaj njësi,në bazën e qfarë keni me i evidentu? Dhe në fund është çështja nëse kish vazhdu ajo gjendje dhe ish shfaq një epidemi këtu unë kam kërk me ditë kush kish qenë përgjegjës për këtë? A kishim qenë ne si Asambleist,Ekzekutivi apo Eko-Regjioni.

Enver Shabani-Drejtorja e Shërbimeve publike gjithmonë e ka një zyrtar si menaxher për mbikëqyrjen e Eko-Regjionit e në këtë rast sa kam qenë unë ka qenë Fisnik Tahiri besojë që vazhdon me qenë hala dhe Jeton Sallauka si anëtar i bordit që përfaqëson Komunën e Suharekës i bjen raportet koh pas kohe,atëher faji mbetet te Drejtorja e Shërbimeve publike që në këtë rast kërkush nuk ka kërk ndonjë raport të tillë,sepse nëse i lypim sot raportet e vitit kalum sigurisht që dikun gjenden në arkivat e Drejtorisë dhe këto Fisniku i gjen pa ndonjë problem.

Avni Bytyçi-ligji i tatimit në pronë e obligon Komunën për qdo vit 20% të tatim paguesve mi verifiku në territorin e Komunës së Suharekës edhe këta Eko-Regjioni në bashkëpunim me Komunën që 20%,30% me bë verifikim në territor jo me nejtë në zyre.

Flamur Bytyçi-ne po i lëshojmë 50,000 fatura të tatimit në pronë e në Eko-regjion i kemi 8000 konsumator ekonomi familjar,ai duhet të regjistrojë sa më shumë dhe nuk ka nevojë me u rrit çmimi.

Amir Hoxha-Kolegjiumi i Drejtorave të Shërbimeve publike bashk asociacionin e Komunave jan duke dhën komente në ligjin që është duke e bë Ministria Ambientit për menaxhimin e mbeturinave ,ne kemi rol komentues aty dhe aty është duke u bë një udhëzues special për Komuna dhe ne nuk mundemi këtë rregullore që e kemi bë me bë në mënyrë të pavarur,është një skilet i udhëzimeve të posaqëme që kemi me ju përmbajtë kur të bëhet ligji,ligjin është duke. Ebë ministria është te suportu Gizi mirpo ata kan ngecje përshkak të ndrrimit të Qeverisë,psh një specifik ishte mjetët me i mbledhë Komuna për Eko-Regjionin në një mënyrë është shumë komplekse kjo sepse po duhet me i ndrru dy tri hallka ligjore për me bë Zyrtarë që i mbledhin ato me marrë të tjera normativa krejt edhe ata tash jan duke dhën sugjerim që nuk ka mundësi kështu se duhet me procedu ndryshim ligji edhe te Financat.

Sanie Kuçi Rexhepaj-po lidhem te fjala e Drejtorit që tha raporti mundet me qenë Drejtori,kërkesa ime është a mundet me na u sjellë ai raport në Kuvend,sepse ne e kemi kërk që me pa një gjendje

të 2025 qka ka punu Eko-Regjioni sa janë të hyrat të dalurat dhe komplet çështjet tjera për Kuvend dhe kërkesa tjetër a mundemi me pas marrëveshjen që e ka Komuna me Eko-Regjionin për me ditë qka ka kompetencë Eko-Regjioni qka jo deri kur e ka marrëveshjen për sa kohë jemi tu fol, kështu që ta shohim atë marrëveshje ndoshta edhe shuhen disa diskutime të tjera.

Dardan Berisha-nëse përseritet e njëjta situat cilat jan procedurat ligjore që duhet me ndjek Kryeshefin pse nuk pe merrë bërllugin, ose Eko-Regjioni a ka të drejtë me na lan në atë kaos apo nuk ka të drejtë me ligj.

Laureta Tafaj-unë sot propozojë që ne së bashku deri para ditës së seancës së Asamblesë me i shfrytëzu të gjitha resurset të cilat mundemi me i shfrytëzu ,një takim me Kryetaarin, një takim me Ministrin, zyrtari ligjor i mbledhë të gjitha faktet qka na mundemi me dal fitus para Kryeshefit Ekzekutiv sepse nuk është kërkush me ardhë me na kërcënu edhe me lujt me qytetarët e ton, nuk mundemi ne me qenë Komuna e par në Kosovë që e rrit tarifën me 7.5 derisa as Prishtina hala si Kryeqytet nuk e pagun, hajde të bëhemi bashkë dhe ti mbledhim të gjitha mundësit me fakte të dalim para Kryeshefit ti thpjm jo nuk ka me kan kështu deri sa të normalizohet në të gjithë territorin e Kosovës dhe tani edhe ne mundemi me rrit, sepse ti ki drejtë me prit ti ki me mbledhë bërllugin ti ki me i pagu punëtorët sikurse në të gjitha Komunat që po e bën ky është propozimi jem nëse kolegët e mi pajtohen me mu.

Avni Bytyçi-në momentin që ka kalu me 6 edhe Komuna edhe Asamblea edhe Eko-Regjioni në një far forme kan pranu se me qdo kusht nëse ju kujtohet Kryeshefi insistojke që të kalon mbas dy dite ka ndodh ai kaos, Kryesuesi nuk ka qenë këtu kan mbajtë takim Kryeshefi te Kryetari dhe këta kan insistu me qdo kushtë me qitë pik urgjente me rrit 7.5 dhe un nuk kam pranu sepse ja kam sqaru aspektin ligjor pa u kthy ligjshmeria e rregullores kjo çështje nuk ban.

Kryesuesi-e hedhë në votim

5 për, 2 abstenime miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënie e shpërblimeve ‘Emblema e artë’, ‘Skenderbeu’, dhe mirënjohjen ‘13 Qershor’;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-ne si grupi i grave në këtë pjesë e kemi propozu që një grua kësaj here me marrë çmimin Emblema Artë

Mimoza Bajraktari-nuk ka pas kërkesë.

Sanie Kuçi Rexhepaj-me një far lloj mirëkuptimi po e kërkojë në këtë fazë nuk po du me përmend në Asamble përshkak se ne edhe vitin e kalum ne si grup i grave e kemi pas kërkesë zyrtare që një grua me marrë çmimin “Emblema e Artë” përshkak që ska pas asnjëher gra që e kan marrë këtë shpërblim, në këtë vit ne si grup i grave e kemi diskutu prap mirpo kemi kërku prej Kryetares

të grupit që fillimisht me u diskutu që paraprakisht është dakordu me marrë një person i caktum mos me ra komisioni në lajthitje përshkak se është diqka shumë e ndjeshme,dhe kërkoj mirkuptimin e juj që në dy vite e ardhshëm me i taku një grua “Emblema e Artë” dhe unë jam e gatshëm me bë kërkesën zyrtare por me pas një dakordimi paraprak sepse e meritojnë.

Kryesuesi-unë ka me qenë zë i kësaj që në vitin e ardhshëm ti jepet një gruas qmimi “Emblema e Artë”.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit të ankesave për bursa për nxënës dhe student;

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal;

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-17647;

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8.Njoftim për shkëputjen e kontratës

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj-në mbledhjen e kaluar ne e kemi diskutu çështjen te gurëthyesit vendimi që ke shumë i përgjithshëm për veprimtari biznese,njëjtë edhe kjo kontratë në të njëjtë form po kalon më duket kemi qenë në mandatin e parë dhe unë kam qenë Drejtoreshë dhe më pat ardhë kërkesa për leje ndërtimore dhe kur e merrë kontraten e lexon për veprimtari biznese dhe tash Drejtorin e Urbanizmit po e qitni në lajthitje dhe komplet drejtorin me atë zyrtarin që e merrë atë land në shqyrtim,për veprimtari biznese dhe aty ishte tok bujqësore qfar buznesi në bujqësi mundesh me lidhë tash po duhet me kamoflu çështjen e vendimit të Kuvendit,ju lutemi vendimet e radhës mos na bjerni për veprimtari biznese por cekni për qka është gjithmonë në përputhje me hartën zonale.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi 11:30